

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6160  
E hënë, 9 nëntor 2020  
çmimi 0.40 €

Sot Thaçi dhe  
Krasniqi dalin para  
Gjykatës Speciale | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



## OPINION

Ç'ORKESTËR KUNDËR  
ÇLIRIMTARËVE! | F. 10-11

Shkruan:  
Agron HOTI



## AKTUALE



EDHE 11 VIKTIMA DHE 730  
TË INFETUAR ME COVID  
NË KOSOVË | F. 7

FITORJA E BIDENIT PËRLLOT  
GAZETARIN E CNN-it | F. 2

NË 24 ORËT E FUNDIT NË  
SHQIPËRI, 501 RASTE ME COVID  
| F. 2

## EKONOMI



'TREPÇA' KA 8 MILIONË EURO  
BORXHE, KËRKOHET NDIHMA E  
QEVERISË | F. 9

KËTË VIT PËRFITIMI  
NGA DIASPORA PRITET  
TË JETË I VOGËL | F. 8

## SPORT

MANAJ ME KËMBË NË TOKË:  
ENDE NUK JAM AMBIENTUAR  
NË TURQI | F. 16

SHTETET E BASHKUARA  
TË AMERIKËS (SHBA) KANË  
PRESIDENT TË RI

# JOE BIDEN, PRESIDENTI I 46 | SHBA-së

- Republika  
e Kosovës  
përgëzon  
Joe Bidenin  
për fitore

Kandidati demokrat Joe Biden është presidenti i 46 i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së). Fitorja e Bidenit është arritur pas triumfit të tij në Pensilvania, e cila ia ka siguruar votat e nevojshme për t'u bërë president i ShBA-së. Në fjalimin e fitores, Bideni është zotuar se do të jetë një president që nuk kërkon ta ndajë, por ta bashkojë vendin. Presidentin e ri të ShBA-së e kanë përgëzuar përfitore liderët politikë të Kosovës dhe shumë liderë botërorë | FAQE 4-5

**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni  
Xheqciq-Tetovë  
Curë-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endri Shaqiri  
+38344685122

Internet Website,  
Marketing...

## Në 24 orët e fundit në Shqipëri, 501 raste me Covid

**TIRANË, 8 NËNTOR** - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Shqipëri ka publikuar shifrat sa iu përket infektimeve dhe viktimave nga Covid-19 në 24 orët e fundit. Nga 1 942 testime, 501 kanë rezultuar pozitiv me Covid-19. Ndërkohë dy pacientë nuk kanë mundur ta fitojnë betejën me këtë virus. Lajm i mirë është shërimi i 90

pacientëve, por që gjithsesi nuk e lehtëson situatën në spitalet e Shqipërisë. Sipas njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë, 374 patientë ndodhen aktualisht në spitalet Covid, katër të intubuar dhe 13 në terapi intensive. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve t'i

respektojnë me përpikëri rregullat e higjienës, distancimit fizik dhe mbajtjen e maskës në çdo ambient jashtë shtëpisë. "Është e rëndësishme të shmanget lëvizjet e panevojshme dhe të kufizohen kontaktet, për ta parandaluar përhapjen e Covid-19", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



## Fitorja e Bidenit përlot gazetarin e CNN-it



**WASHINGTON, 8 NËNTOR** - Menjëherë pas rrjetet televizive njoftuan se Joe Biden kishte fituar Pensilvaninë, e përrjedhojë, kishte siguruar votat e nevojshme për presidencën amerikane, analistët në ShBA shpërthyen në komente për këtë zhvillim, i cili ishte i pritshëm tashmë. Por asnjë reagim nuk ishte aq emocional sa ai i gazetarit të CNN-it, Van Jones, i cili nuk i mbajti dot lotët derisa

përpiquej të shpjegonte se çfarë nënkupton përvendin fitorja e kandidatit demokrat. "Këtë mëngjes ishte më e lehtë të ishe një prind. Ishte më e lehtë të jesh baba dhe t'u thuash fëmijëve të tu se karakteri vlen. Se e vërtet vlen. Se të jesh një njeri i mirë, vlen. Dhe është më e lehtë për shumë njerëz. Nëse je një mysliman në këtë vend, nuk do të duhet më të shqetësohesh se presidenti nuk do që të jesh këtu. Nëse je një emigrant, nuk duhet të shqetësohesh se presidenti do të gëzohet kur të marrin fëmijët. Ky është lehtësim për shumë njerëz që kanë vuajtur", ka thënë Jones. Televizionet CNN, NBC, CBS, ABC e media të tjera njoftuan se Joe Biden është fitues i zgjedhjeve presidenciale të shtunën në duelin e ashper me presidentin aktual, Donald Trump.

## 31 vjet nga rënia e Murit të Berlinit

**BERLIN, 8 NËNTOR** - Kanë kaluar 31 vjet që nga shembja e Murit të Berlinit i cili ishte bërë simbol i Luftës së Ftohtë. Muri, ndërtimi i të cilët filloj më 13 gusht të vitit 1961 dhe i cili e shndërrroi në një ishull Berlinin Perëndimor në Gjermaninë Lindore, u shemb më 9 nëntor të vitit 1989.

Gjermania u nda në dy pjesë, lindje dhe perëndim, menjëherë pas Luftës së Dytë

Botërore, ndërkohë që muri, i cili ndante qytetin e Berlinit në dy pjesë, ende kujtohet si "muri i turpit", edhe pse kanë kaluar 31 vjet nga rënia e tij. Gjermania, e cila pësoi disfatë në luftë, u nda në katër pjesë nga ShBA-ja, Britania, Franca dhe Bashkimi Sovjetik, të cilat vendosën ta ndajnë në katër pjesë edhe Berlinin, kryeqytetin gjerman deri në Luftën e Dytë Botërore.

Administratat e rajoneve të kontrolluara nga ShBA-ja, Britania dhe Franca u bashkuan në vitin 1949 përvenduan atë që u njoh si Republika Federale e Gjermanisë (BRD), ndërsa rajoni, nën adminstrimin sovjetik, në të njëjtin vit u shpall si Republika Demokratike e Gjermanisë (DDR). Dy Gjermanitë u bashkuan zyrtarisht 11 muaj pas shembjes së murit, më 3 tetor të vitit 1990.



## Irani shpreson se politika amerikane do të ndryshojë pas fitores së Bidenit

**TEHRAN, 8 NËNTOR** - Irani shpreson se politika amerikane do të ndryshojë pas fitores së Joe Bidenit në zgjedhjet presidenciale, ka thënë nën-presidenti i Republikës Islamike, Eshaq Jahangiri. "Epoka e Donald Trumpit dhe ekipit të tij aventurist dhe luftënxitës, më në fund ka mbaruar. Ne shpresojmë se Shtetet e

Bashkuara do t'i ndryshojnë politikat e tyre shkatërruese", ka thënë Jahangiri. Sipas tij, ShBA-ja duhet t'u kthehet obligimeve ndërkombëtare pas përfundimit të procesit zgjedhor. Përveç kësaj, Jahangiri ka thënë se Irani ka qenë i shqetësuar ashtu



sikurse e ka përmendor presidenti Hassan Rohani përkthimin e ShBA-së në marrëveshje në bërthamore që Irani ka nënshkruar me fuqitë botërore dhe heqjen e sanksioneve. Presidenti amerikan Donald Trump është tërhequr nga marrëveshja bërthamore më 2018,

sipas së cilës, Irani do të duhej ta kufizonte aktivitetin bërthamor në këmbim të lirimt nga sanksionet. Përveç këtij veprimi, Trump ka aplikuar fushatë me presion maksimal ndaj Iranit. Sanksionet kanë dëmtuar rëndë ekonominë iriane, duke mos harruar edhe përkqësimin që ka nxituar pandemian e koronavirusit.

## Udhëheqësi i Meksikës refuzon ta njohë fituesin e zgjedhjeve në ShBA

**WASHINGTON, 8 NËNTOR** - Presidenti meksikan Andres Manuel Lopez Obrador ka deklaruar se do të jetë i përm-bajtur nga shpallja e cilitdo kandidat fitues në zgjedhjet e

ShBA-së. Ai ka theksuar se kjo është një çështje respektive "mirësjelljeje politike". "Ne do të presim që të përfundojnë të gjitha çështjet ligjore në pritje. Nuk duam të jemi të

pamatur. Duhet ta respektojmë autonominë e vendeve të tjera", ka thënë ai në një konferencë përmes media në shtetin Tabasco në jug të Meksikës. Joe Biden shpalli fitoren në

zgjedhjet presidenciale pasi deri më tanë ka marrë 279 vota të Kolegit Zgjedhor, 20 më shumë nga 270 sa nevojiten përvendosur bërë president i ShBA-së.



# Sot Thaçi dhe Krasniqi dalin para Gjykatës Speciale

Ish-presidenti Hashim Thaçi do ta bëjë paraqitjen e parë sot (e hënë) para gjyqit të Gjykatës Speciale në Hagë. Po këtë ditë do të paraqitet para këtij institucioni edhe ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi.

**EPOKA ERE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Dhomat e Specializuara në Hagë kanë njoftuar se sot (e hënë), duke filluar nga ora 11:00, do të mbahet seanca e parë ndaj ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqit. Po këtë ditë do ta bëjë paraqitjen e parë duke filluar nga ora 15:00 edhe ish-presidenti Hashim Thaçi.

Ndërkaq ish-kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, do ta bëjë paraqitjen e parë para gjyqit të këtij institucioni më 10 nëntor. Kurse deputeti i Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi, do të paraqitet para Dhomave të Specializuara më 11 nëntor. Sipas aktakuzës, veprat që rëndojnë ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit kanë të bëjnë me kime lufte, ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme dhe kime kundër njerëzimit, burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje të paligjshme, zhdukje me forcë të personave dhe përndekje, të cilat, sipas Dhomave të Specializuara, janë kryer midis marsit të vitit 1998 dhe shtatorit 1999.

Që të gjithë gjenden në qendrën e paraburgimit në Hagë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuuar, që ndryshe njihen edhe si Gjykata Speciale, hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 e deri në dhjetor të vitit 2000. Këto kime të pretenduara përmenden në një raport të Këshillit të Evropës, të vitit 2011, autor i të cilit është senatori zviceran Dick Marty. Hetues të Prokurorisë së Specializuuar në Hagë dhe policë të EULEX-it kanë bastisur të premten që lamë pas shtëpinë e ish-presidentit Hashim Thaçi, të shefit të PDK-së, Kadri Veseli, dhe të ish-shefit të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi. Këto bastisje kanë ndodhur një ditë pasi ata janë transferuar në Qendrën e Paraburgimit në Hagë, pas konfirmimit të aktakuzave për kime lufte dhe kime kundër njerëzimit. Dastid Pallaska, në cilësinë e njërit prej avokatëve mbrojtës të Hashim Thaçi në procesin gjyqësor në Hagë, ka thënë se është e paqartë pse bastisja është kryer pas konfirmimit të aktakuzës, derisa ka shtuar se Prokuroria është duke kërkuar ende prova për ta



mbështetur aktakuzën tanimë të konfirmuar.

Edhe Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar ndaj bastisjeve që po bëhen nga EULEX-i në shtëpinë e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, dhe shefit të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi. Në reagimin e KMDLNj-së është thënë se policia e EULEX-it po shpërfill skajshmërisht institucionet e Kosovës, ndërsa Policinë e Kosovës po e përdor si "punëtore krahu".

Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, gjatë mbledhjes së qeverisë e cila është mbajtur javën e kaluar, ka komentuar zhvillimet e fundit dramatike rrëth

Gjykatës Speciale. Ai ka thënë se gatishmëria e të akuzuarve për bashkëpunim me Hagën ka vërtetuar pjekurinë politike dhe idealin që ka pasur lufta jonë. "Gatishmëria për bashkëpunim me Prokurorinë Speciale e të akuzuarve vërteton pjekurinë politike dhe idealin që ka pasur lufta jonë", ka thënë ai. Veliu ka bërë me dije se kanë edhe një plan për të parandaluar ndonjë incident të mundshëm pas këtyre zhvillimeve. "Policia në planin e vet ka përfshirë masat që kanë mbrojtjen e zonave me popullsi të përzier në rast të ndonjë incidenti të mundshëm, por edhe planin që përban të gjithë skenarët e mundshëm. Policia ka vendosur me të gjitha mjetet të përgjigjet në një situatë të mundshme. Është rritur edhe niveli i gatishmërisë", ka

thënë Veliu. Konfirmimi i aktakuzave për Thaçin, Veselin, Krasniqin dhe Selimin ka nxitur reagime të shumta në Kosovë dhe në Shqipëri. Liderë politikë dhe bashkëluftëtarë të tyre kanë dalë në krahë të ish-udhëheqësve të UÇK-së, duke besuar fuqishëm në pafajësinë e tyre. Ndërkaq ushtruesi i detyrës i kreut të OVL UÇK-së, Faton Klinaku, ka njoftuar se Këshilli Drejtues i kësaj organizate ka vendosur për organizimin e një proteste. Në një konferencë për media, ai ka dekluaruar se për datën se kur do të mbahet protesta pritet të vendoset në ditët në vijim. Klinaku ka thënë se protesta do të jetë paqësore duke respektuar rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

## Rama akuzon Metën, Berishën dhe Bashën për mbështetjen e akuzave kundër liderëve të UÇK-së



**PRISHTINË, 8 NËNTOR** - Konfirmimi i aktakuzave ndaj ish-kryerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ka shkaktuar debat të madh edhe në Shqipëri. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i ka akuzuar kundërshtarët politikë, Ilir Metën, Sali Berishën dhe Lulzim Bashën, se e kanë mbështetur raportin e ish-deputetit të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës Dick Marty, mbi krimet e pretenduara se janë kryer nga UÇK-ja.

Rama i ka pyetur këtë se pse kanë votuar pro raportit të ish-senatorit zviceran. "Ilir, a mund t'ua thuash

shqiptarëve pse votove pro raportit të Dick Marty, bashkë me Saliun kur ne e votuan kundër? Po ti Lulëzim, a e sqaron dot çfarë dosje ke përgatitur për sajësën e Shtëpisë së Verdhë bashkë me mjekun peruan që dëshmon se ti ke mbledhur dëshmitë bashkë me të? Lulëzim! Mos u fshih pas Covidit dhe lëri akuzat për ata që po luftojnë përditë në vijen e parë kundër virusit, po përgjigju përfaktin që ke qenë bashkë me mjekun peruan në bëjen e dosjes për Shtëpinë e Verdhë! E thuaje çfarë mendon për votën e PD-LSI pro raportit të Dick Marty!", ka thënë Rama.

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) KANË PRESIDENT TË RI

# JOE BIDEN, PRESIDENTI I 46 I SHBA-së



## - Republika e Kosovës përgëzon Joe Bidenin për fitore

Kandidati demokrat Joe Biden është presidenti i 46-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Fitorja e Bidenit është arritur pas triumfit të tij në Pensilvania, e cila ia ka siguruar votat e nevojshme për t'u bërë president i ShBA-së. Në fjalimin e fitores, Biden është zotuar se do të jetë një president që nuk kërkon ta ndajë, por ta bashkojë vendin. Presidentin e ri të ShBA-së e kanë përgëzuar për fitore liderët politikë të Kosovës dhe shumë liderë botërorë

përkrahësve të shumtë. "Njerëzit e këtij vendi folën. Ata na dhanë një fitore të qartë, një fitore bindëse", ka deklaruar Bideni përpëra mbështetësve të mbledhur në një parking dhe që brohoritn përfitorin tij. Ai është zotuar se do të jetë një president që nuk kërkon ta ndajë, por ta bashkojë vendin. "Unë e kërkova këtë post për ta rikthyer shpirtin e Amerikës dhe për ta bërë Amerikën të respektuar përsëri në botë", është shprehur ai. Pa përmendur drejtëpërdrejt rivalin e tij republikan, Biden iu ka drejtuar 70 milionë amerikanëve të cilët votuan në mbështetje të

presidentit Trump, disa prej të cilëve dolën në rrugë të shtunën për të demonstruar kundër rezultateve. "Të gjithë atyre që votuan për presidentin Trump, unë e kuptoj zhgënjimin sonte. Unë vetë kam humbur disa herë. Por, tani, le t'i japim njëri-tjetrit një shans. Është koha të heqim dorë nga retorika e ashpër, ta ulim temperaturën, të shikojmë dhe dëgjojmë njëri-tjetrin përsëri. Kjo është koha e shërimit në Amerikë", ka deklaruar ai. Sipas tij, populli amerikan dëshiron që demokratët dhe republikanët të bashkëpunojnë. "Unë do të punoj po aq shumë për ata që nuk më votuan sa edhe për ata që më votuan", ka deklaruar ai.

Bideni ka njoftuar se të hënën do të shpallë një grup shkencëtarësh dhe ekspertësh për ta ndihmuar atë të hartojë një plan për trajtimin e pandemisë së koronavirusit. Ai ka deklaruar se këta këshilltarë do t'i shqyrtojnë propozimet për trajtimin e pandemisë që ai bëri gjatë fushatës për t'i kthyer ato në një projekt që ai do ta miratojë kur të inaugurohet si president janarin e

ardhshëm. Propozimet përfshijnë investime në pajisjet mbrojtëse personale dhe kredi për bizneset e vogla, si dhe plane për të zbatuar udhëzime më të standardizuara të shëndetit publik.

Bideni ka treguar se plani i tij do të ngrihet mbi shkencën e shëndoshë.

Para simpatizantëve ka folur edhe senatorja Kamala Harris, e cila do të jetë gruaja e parë afrikano-amerikane dhe e para amerikane me originë aziatike që shërben si zëvendëspresidente.

Ajo ka thënë se është "dëshmi e karakterit të Bidenit fakti që ai pati guximin të thyente një nga pengesat më thelbësore që ekziston në vendin tonë dhe të zgjidhte një grua si zëvendëspresidenten e tij".

Fitorja e Bidenit, 77 vjeç, ka ardhur pas më shumë se tri ditëve të paqartësive, teksha zyrtarët zgjedhorë kanë numëruar votat përmes postës. Trumpi është presidenti i parë aktual që humbet në procesin e rizgjedhjes, prej kohës së republikanit George H. W. Bush më 1992.

**Liderët politikë në Kosovë urojnë Bidenin për fitoren në ShBA**

Pas fitores në garën presidenciale, Joe Biden, liderët politikë të Kosovës e kanë përgëzuar për fitoren. Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka uruar presidentin e zgjedhur Joe Biden dhe nënpresidenten e zgjedhur Kamala Harris për fitoren e tyre në zgjedhjet amerikane të 3 nëntorit. "Jam e bindur se nën udhëheqësinë tuaj si president amerikan dhe nënpresidente amerikane, demokracia do të lulëzojë në Amerikë dhe në gjithë botën", shkruar ajo në "Twitter". Edhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka uruar presidentin e zgjedhur Biden dhe nënpresidenten e zgjedhur Harris për fitoren në zgjedhje. "Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i përcjell urimet më të përzemërtë presidentit të zgjedhur, Joe Biden dhe zëvendëspresidentes



Kamala Harris, për fitore në zgjedhjet presidenciale në ShBA", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, fitoren e Bidenit e ka quajtur historike. "Le ta vazhdojmë punën tonë së bashku për t'i fuqizuar lidhjet strategjike në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara", ka shkruar ai në "Twitter".

Edhe liderët opozitarë e kanë përgëzuar kandidatin demokrat. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në llogarinë e vet në "Twitter" ka thënë se fitoja e Bidenit është historike dhe se ai është aleat i Kosovës.

"Udhëheqësia juaj është e nevojshme në Amerikë po aq sa në botë, për të rikthyer besimin në demokraci, sundim të ligjt dhe dinjitet njerëzor. Mezi pres t'i forcojmë lidhjet tona", ka thënë ai. Kurse ushtruesi i detyrës i

kryetarit të PDK-së, Enver Hoxhaj, fitoren e Joe Bidenit për president të ShBA-së e ka vlerësuar fitore të vlerave euro-atlantike. "Presidenti i zgjedhur Biden ka qenë dhe mbetet një mik i madh dhe mbështetës i shkëlqyeshëm i Kosovës së lirë e të pavarur dhe i popullit të saj. Kjo është një fitore e vlerave euro-atlantike, lirisë dhe demokracisë, që janë shtyllat e Kushtetutës dhe aleancës sonë me ShBA-në!", ka shkruar Hoxhaj në llogarinë e vet në "Facebook".

#### Liderë botërorë urojnë Bidenin

Presidentit të ri të ShBA-së nuk i kanë munguar urimet as nga liderët më të fuqishëm botërorë. "Ne kemi shumë punë për të bërë, për t'i tejkluar sfidat e sotme. Le të punojmë bashkë", ka

shkruar në "Twitter" presidenti francez Emmanuel Macron. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara janë vende mike dhe aleate. "Qytetarët tanë kanë lidhjet më të forta. Mezi pres të punoj me presidentin e zgjedhur Biden", ka shkruar ajo.

Kurse kryeministri britanik Boris Johnson ka përgëzuar Bidenin për arritjen e tyre historike. "Shtetet e Bashkuara janë aleati ynë më i rendësishëm dhe unë pres që të punojmë ngushtë së bashku në përparësitet tona të përbashkëta, që nga ndryshimi i klimës te tregtia dhe siguria", ka thënë kryeministri Johnson. Në një letër në adresë të Bidenit, udhëheqësi shpirteror Dalai Lama e ka përshëndetur zgjedhjen e presidentit të ri amerikan. "Njerëzimi ushqen shpresë të madhe në vizionin

## Kush është Joe Biden?

Joseph Robinette Biden, i Riu, ka lindur në vitin 1942 në qytetin Skranton të Pensilvanisë, në një familje të klasës së mesme katolike romake. Familja e tij më vonë është zhvendosur në qytetin Uillmington në Dellauer dhe babai i tij ka punuar si shitës i makinave të përdorura. Bideni ka luajtur futboll amerikan dhe bejsboll në shkollën e mesme katolike. Më pas ka ndjekur studimet në Universitetin e Dellauerit dhe ka marrë diplomë në drejtësi nga Universiteti Sirakjuz në shtetin e Nju Jorkut. Bideni është martuar për herë të parë në vitin 1966 me Neilia Hunter, studente në Sirakjuz. Çifti është zhvendosur më pas në Dellauar ku Bideni ka kaluar provimin e kërkuar për ta ushtruar profesionin e avokatitës dhe ka pasur tre fëmijë.

Neila dhe vajza e tyre kanë humbur jetën në një aksident me makinë derisa bënin pazare për Krishtlindje. Ngjarja ka ndodhur më 1972, vetëm disa javë pasi Biden, atëbotë 29 vjeç, është zgjedhur për herë të parë senator. Djemtë e tyre, Hunter dhe Beau, janë lënduar në aksident.

Beau ka vdekur nga kanceri në tru, në moshën 45 vjeçë, në vitin 2015. Hunter, tani 50 vjeç, ka luftuar me varësinë nga alkooli dhe droga për dekada. Bideni ka thënë se gati ka hequr dorë nga Senati për t'u kujdesur për fëmijët e tij pas aksidentit, porse kolegët e kanë bindur që të mos e bëjë një gjë të tillë.

Për të qenë pranë djemve të tij, ai ka udhëtuar 90 minuta me tren nga shtëpia në Dellauer për në Washington. Udhëtimi ditor ka pasur ndikim edhe në politikën e tij. Ai është bërë avokat i transportit hekurudhor dhe, në kuadër të fushatës këtë



vit, ka bërë thirje për një "revolucion hekurudhor" që, sipas tij, do të luftonte ndryshimet klimatike dhe do t'i ndihmonte njerëzit e klasës punëtore që mbështeten në transportin publik. Në rrininë e tij, Bideni ka vuajtur edhe nga belbzimi, që vazhdon t'i shfaqet kohë pas kohe. Gjatë garës së sivjetme, kundërshtarët ia kanë përdorur këtë tipar, së bashku me moshën e tij të vjetër, për të hedhur dyshime mbi aftësitë e tij si president. Edhe pse kurrë nuk e ka humbur garën për Senat gjatë 35 vjetëve, Bideni ka duruar pengesa në karrierën e vet politike.

Ai ka garuar për nominimin e Partisë Demokratike për kandidat presidencial më 1988 dhe sërisht më 2008, por është mundur nga garuesit e tjere. Bideni ka shpallur kandidaturën për president në prill të vitit 2019, pas disa muajsh hezitim dhe kur disa kandidatë të tjerë, shumë të rinj, më liberalë ose me prirje të majta dhe shumë më të rinj në politikë sesa Biden kishin hyrë në garë. Bideni ka bërë përpjekje ta paraqesë veten si fener stabiliteti në një vend që, sipas tij, ishte bërë "fushë e betejës", pas tre vjetësh nën Trumpin.

dhe udhëheqjen demokratike të Shteteve të Bashkuara. Në veçanti në këto kohë të vështira shpresoj të jeni në gjendje të kontribuoni për t'i dhënë formë një bote më të paqtë, ku njerëzit

që vuajnë nga varfëria dhe padrejtësia, të gjunjë çlirim. Nevoja për t'iu përgjigjur këtyre problemeve, si dhe ndryshimeve klimatike, është vërtet urgjente", ka shkruar Lama.

## Trumpi nuk e pranon rezultatin

Presidenti aktual Donald Trump, i cili ishte duke luajtur golf kur rrjetet kryesore televizive parashikuante që rivali i tij kishte fituar, ka akuzuar menjëherë Bidenin se po nxitonë të paraqitej në mënyrë të padrejtë si fitues. Ai pretendon se ka fituar zgjedhjet e 3 nëntorit, duke thënë se ka fituar 71 000 000 vota në mënyrë të ligjshme. Pasi është kthyer në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi ka thënë se gjëra të këqija kanë ndodhur gjatë procesit zgjedhor dhe se vëzhguesit republikanë nuk

kanë pasur qasje. "Kjo nuk ka ndodhur kurrë më parë. Miliona vota përmes postës u janë dërguar njerëzve të cilët nuk i kanë kërkuar kurrë në rend të parë", ka shkruar ai në rrjetin social "Twitter". Ekipi i presidentit Trump ka thënë të shtunën se kishte ngritur padi në Arizona, në të cilën pretendon se qarku më i populluar i këtij shteti jugperëndimor shkualifikoi në mënyrë të gabuar një numër votash të hedhura ditën e zgjedhjeve nga disa votues.



## Drejtoresha Jetullahi viziton disa biznese në Drenas

**DRENAS, 8 NËNTOR (ER)** - Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Drenasit, Egzona Jetullahi, ka vizituar bizneset/zejet të cilat operojnë në Drenas e që merren me zdrukthëtarit.

Drejtoresha Jetullahi së bashku me stafin e kësaj drejtoria kanë vizituar zdrukthëtarinë e "Vëllezërit Shala" në Krajkovë, zdrukthëtarinë "Pishat" të vëllezërve Ramaj në Drenas "Pishat" si dhe zdrukthëtarinë "Thaqi" në Komoran.

Kompania e vëllezërve Shala daton që nga viti 1993 dhe, sipas pronarit të kësaj kompanie, Lulzim Shala, punëtoria në atë kohë ishte e thjeshtë, por frysonte me një ide të madhe. Sot kjo kompani ka teknologjinë më moderne ku çdo produkt i tyre bart

vulen e mjeshtërisë së përsosur dhe dashurisë ndaj punës që bëjnë.

Zdrukthëtaria "Vëllezërit Shala" nga Krajkova, po ashtu vazhdon t'i ndihmojë familjet në nevojë me produkte e tyre. Zdrukthëtaria "Thaqi" në Komoran daton nga viti 1973, me pronarin e parë Rexhep Thaqi, kurse Enver Thaqi tash është gjenerata e tretë që vazhdon këtë veprimtari. Sipas pronarit, puna e realizuar me vullnet dhe dëshirë si në të kaluarën ashtu edhe tash i tejkalon të gjitha vështirësitë që mund të paraqiten gjatë punës. Zdrukthëtaria "Pishat" në Drenas është biznes dhe traditë familjare e cila daton që nga viti 2002. Të gjitha punimet e kompanive punohen nga druri më cilësor me pronarë Besim dhe Selim



Ramaj. Sipas pronarëve, avancimet e pajisjeve kanë mundësuar punën me efikasitet dhe përsosmëri më të

lartë. Kombinimet e panumërtë, stilet e ndryshme, ngjyrat dhe kërkësat e palëve përfunksionalitet specifik janë vetëm disa prej gjëra të cilat kompanitë me shumë punë dhe përkushtim i ofrojnë për kërkësat e palëve.

## Vazhdon realizimi i projekteve infrastrukturore në Fushë-Kosovë



**FUSHË KOSOVË, 8 NËNTOR (ER)** - Komuna e Fushë-Kosovës ka bërë me dije se në Sllatinë të Madhe janë duke vazhduar punimet për rregullimin e trotuarit, hapësirave të gjelbëruara dhe për zgjidhjen e

problemit të ujërave atmosferike.

Kryetari i kësaj komune, Burim Berisha, së bashku me mbikëqyrësit e projektit, ka dalë në vizitë te të gjitha punimet që janë në realizim e sipër.

Rregullimi i infrastrukturës është duke vazhduar në Fushë-Kosovë dhe në fshatra, ku kryetari Berisha ka thënë se do të vazhdojë të jetë pranë qytetarëve për zgjidhjen e problemeve të tyre.

## Bashkatdhetari Elezaj dhuron donacion për Komunën e Klinës

**KLINË, 8 NËNTOR (ER)** - Komuna e Klinës ka pranuar një donacion nga bashkatdhetari Shkelzen Elezaj. Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëgenies Sociale në Klinë, Shemsedin Berisha, ka shprehur falënderim për Elezajn, duke theksuar se ky donacion është në shërbim të kategorisë në nevojë të kësaj

komune. Ai ka thënë se njerëz të tillë vullnetmirë dhe të cilët me humanitetin e tyre "kanë bërë gjithmonë që ne të jemi krenarë ka pasur gjithmonë komuna jonë, megjithatë z. Elezaj u shndërrua në një model edhe për të tjerët që dëshirojnë që komuna jonë të jetë ndryshe".



## Fillon asfaltimi i rrugës në Zabërxhë të Mitrovicës

**MITROVICË, 8 NËNTOR (ER)** - Komuna e Mitrovicës ka vazhduar realizimin e projekteve kapitale në fushën e infrastrukturës, me ç'rast rruga e fshatit Zabërxhë ka nisur të asfaltohet. Me këtë rast, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, së bashku me drejtorin për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, si dhe drejtorin e Inspeksionit, Fidan Ademi, kanë marrë pjesë në fillimin e rregullimit të rrugëve në këtë fshat.

Bahtiri bëri me dije se të gjitha rrugët në këtë fshat do të janë të rregulluara e asfaltuara sipas

standardeve të parashikuara. Ky projekt është mirëpritur shumë nga banorët e Zabërxhës, të cilët i kanë falënderuar drejtuesit komunalë për asfaltimin e rrugës, pasi kanë vlerësuar se këto investime në Shalë të Bajgores kanë një kuptim të veçantë, sepse do t'ia kthejnë perspektivën kësaj ane që ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit.

Rruga që nisi të asfaltohet ka një gjatësi prej 6 kilometresh e 300 metresh dhe është mbështetur financiarisht nga Ministria e Infrastrukturës.



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE I KOSOVËS (IKSHPK) KA PUBLIKUAR RAPORTIN PËR 24 ORËT E FUNDIT PËR SITUATËN EPIDEMIOLOGJIKE RRETH COVIDIT

# Edhe 11 viktima dhe 730 të infektuar me Covid në Kosovë

Kosovës të dielën i janë shtuar 730 raste të reja me Covid-19 pas marrjes së 1 794 mostrave. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar 11 viktima. Sipas të dhënave të këtij Instituti, të dielën janë regjistruar edhe 75 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 7 278

EPOKA  
ERE Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 8 TETOR** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 794 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 730 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të vdekjes nga Covid-19. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Kamenicë dy raste (76 dhe 70 vjeç), Prishtinë dy raste (78 dhe 71 vjeç), Vushtrri dy raste (82 dhe 77 vjeç), Gjilan një rast (58 vjeç), Pejë një rast (62 vjeç), Prizren një rast (58 vjeç), Rahovec një rast (66 vjeç) dhe Suharekë një rast (71 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 24 155 raste nga 106 770 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 755 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 75 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 16 122 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 7 278. Rastet pozitive janë nga: Komuna Prishtinë 312 raste, Komuna Ferizaj 73 raste, Komuna Gjilan 48 raste, Komuna Podujevë 39 raste, Prizren 33 raste, Komuna Gjakovë 31 raste, Komuna Pejë 26 raste, Komuna Fushë-Kosovë 21 raste, Komuna Viti 15 raste, Komuna Deçan 13 raste, Komuna Mitrovicë 12 raste, Komuna Lipjan 11 raste, Komuna Shtime 11 raste, Komuna Novobërdë 10 raste, Komuna Skenderaj 10 raste, Komuna Vushtrri 9 raste, Komuna Kamenicë 8 raste, Komuna Klinë 8 raste, Komuna Suharekë 7 raste, Komuna Kaçanik 6 raste, Komuna Obiliq 6 raste, Komuna Rahovec 6 raste, Komuna Drenas 5 raste, Komuna Malishevë 5 raste, Komuna Istog 3 raste dhe me nga një rast Komunat Graçanicë dhe Hani i Elezit.

Me miratim të kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, Ministria e Shëndetësisë ka marrë vendim që nga ora 20:00 e së premtes deri të hënën, në orën 05:00, t'u ndalohet veprimtaria të gjitha



subjekteve afariste dhe bizneseve, me qëllim të frenimit të përhapjes së koronavirusit.

Në këtë periudhë janë mbyllur edhe qendrat tregtare dhe rekreative dhe subjektet që

ofrojnë shërbime të gastronomisë në të gjithë territorin e Kosovës.

## Zemaj: Rekomandimet e bizneseve do t'i diskutoj me kryeministrin Hoti

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur në takim përfaqësuesit e odave ekonomike, me të cilët ka biseduar për gjendjen pandemike dhe të bizneseve në Kosovë. Zemaj ka thënë se rekomandimet që ka marrë nga përfaqësuesit e bizneseve do t'i diskutojë me kryeministrin Avdullah Hoti. "Para marrjes së masave të reja kam takuar Berat Rukiqin, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, Arian Zeka, kryetar i

Odës Ekonomike Amerikane, Petrit Kllokoqi, kryetar i Shoqatës së Gastronomëve si dhe Hysen Sogojeva, kryetar i Odës Hoteliere të Kosovës. Secili nga ne ndiejmë përgjegjësinë përmbarëvajtjen e shëndetit publik dhe të shëndetësisë, andaj është qenësore që të gjithë së bashku, aty ku veprojmë, t'i zbatojmë rregullat për ta parandaluar përhapjen e virusit sikurse dhe udhëzimet që dalin nga

manuali për mbrojtje nga përhapja e Covid-19. Janë të arsyeshme shqetësimet e secilës kategori të shoqërisë sonë, por të gjithë së bashku duhet të mendojmë për shëndetin publik. Rekomandimet e marra gjatë takimit të sotëm do t'i diskutoj me kryeministrin Hoti në mënyrë që masat e marra nga qeveria të prekin sa më pak ata dhe të janë sa më të lehta për të gjithë ne", ka thënë Zemaj.

# Nga mbyllija e bizneseve në fundjavë, Kosova 'humbet deri në 15 milionë euro'



**PRISHTINË, 8 TETOR** - Deri në 15 milionë euro mund t'i kushtojet ekonomisë së Kosovës mbyllija e bizneseve për dy ditë, thonë përfaqësues të bizneseve. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, pas një takimi që ka pasur me përfaqësues të bizneseve, ka thënë se masat e marra nga qeveria përfrejmim të koronavirusit i konsideron të domosdoshme, mirëpo Rukiqi ka thënë se përkëto masa nuk janë konsultuar fare nga qeveria. "Masat janë të domosdoshme, por kemi një problem me masat e fundit që ishin të pakoordinuara

dhe pakonsultuara me komunitetin e biznesit, edhe pse në masë të madhe e prekin këtë komunitet. Janë mbyllur mbi 20 mijë biznese në vend. Nga këto masa janë prekur këto biznese. Do të kenë dëme në shifra që mund të mbërrinë deri në 10-15 milionë brenda një dite", ka thënë Rukiqi para gazetarëve. Sipas tij, të gjitha paratë që nuk do të shpenzohen në Kosovë, do të shkojnë në shtetet e rajonit, pasi qytetarët kanë shkuar nëpër to për ta kaluar fundjavën. Ai, po ashtu, ka thënë se është i pakuptueshëm lajmërimi i vonshëm i qeverisë përvendosjen e masave të reja për

mbrojtje nga koronavirusi. Të premtën që lamë pas Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që ta mbylli shumicën e bizneseve nga e premtja deri mëngjesin e të hënës, me qëllim parandalimin e përhapjes së koronavirusit. Në këtë vendim janë përfshirë edhe bizneset e gastronomisë. Gjatë së shtunës, Shoqata e Gastronomëve e Kosovës ka mbajtur një aktivitet simbolik për t'i kundërshtuar masat e reja të qeverisë. Bizneset në Kosovë janë ndihmuar me 60 milionë euro në kuadër të Fondit për Rimëkëmbje Ekonomike përgjatë valës së parë të pandemisë së koronavirusit.

# Këtë vit përfitimi i ekonomisë nga diaspora pritet të jetë i vogël

“Ajo çfarë mbetet më me ndikim për ekonominë tonë janë të hyrat nga shpenzimet që bën diaspora gjatë vizitës në Kosovë e të cilat kanë rënë ndjeshëm. Para pandemisë, shpenzimet e diasporës gjatë vizitave në Kosovë llogaritej të kapnin vlerën mbi 328 milionë euro apo 4.6 për qind të BPV-së në vit. Ndërsa këtë vit përfitimi i ekonomisë së Kosovës pritet të jetë i vogël, rrëth 0.55 për qind deri 1.83 për qind të BPV-së”, është theksuar në raportin e institutit GAP

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 8 NËNTOR** - Instituti GAP ka publikuar një raport për ndikimin e diasporës në ekonominë e Kosovës gjatë pandemisë Covid-19. Sipas GAP-it, në një kohë kur ekonomia e Kosovës po pëson rënje si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, roli i diasporës në ekonominë e Kosovës vazhdon të jetë tejet i madh. “Përveç remitencave të cilat kanë shënuar rritje gjatë pandemisë, rënje vërehet në investimet e diasporës në patundshmëri në Kosovë dhe blerje të gjësendeve për familjarët. Ajo çfarë mbetet më me ndikim për ekonominë tonë janë të hyrat nga

shpenzimet që bën diaspora gjatë vizitave në Kosovë e të cilat kanë rënë ndjeshëm. Para pandemisë, shpenzimet e diasporës gjatë vizitave në Kosovë llogaritej të kapnin vlerën mbi 328 milionë euro apo 4.6 për qind të BPV-së në vit. Ndërsa këtë vit përfitimi i ekonomisë së Kosovës pritet të jetë i vogël, rrëth 0.55 për qind deri 1.83 për qind të BPV-së”, është theksuar në raportin e GAP-it.

Përveç frikës nga virusi “Korona”, sipas GAP-it, pengesë për ardhjen e diasporës gjatë verës ishin masat e ndërmarrja nga Kosova dhe shtetet e tjera për qytetarët që e vizitojnë Kosovën. “Rritja drastike e numrit të të infektuarve para sezonit të verës bëri që shumë shtete në Evropë



ta kualifikojnë Kosovën si një ndër vendet me rrezikshmëri të lartë të përhapjes së infeksionit. Shkurtimi i qëndrimit të diasporës në Kosovë ka pasoja të dukshme në ekonominë e Kosovës dhe ka ndikuar negativisht në sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke filluar nga hoteleria, tregtia me pakicë, derivatet, gastronomia etj”, është theksuar në këtë raport. GAP-i në këtë raport ka vlerësuar

se në mënyrë që të shfrytëzohet potenciali financiar i diasporës, Kosova duhet të hartojë politika që nxisin ridestinimin e remitencave drejt investimeve dhe kursimit, duke krijuar platforma investuese apo emituar obligacione qeveritare për diasporën, të ulet kostojë e transferimit të remitencave dhe të rriten programet mbi edukimin financiar të familjeve pranuese të remitencave, Qeveria e Kosovës duhet ta finalizojë regjistrin e diasporës i cili duhet t'i përmbarë fushat e tyre të punës, përvojën profesionale, dhe gatishmërinë për zhvendosje të përkohshme etj., të krijohen rrjetë profesionale dhe plane me qëllime konkrete për inkudrimin e diasporës në ekonomi, të përmirësohet ambienti i biznesit me theks në forcimin e sundimit të ligjit, të drejtave të pronësisë intelektuale dhe transparencës.

## Dymillionëshi i ‘harruar’

**PRISHTINË, 8 NËNTOR** - Ministria e Financave në Qeverinë e Kosovës ka bërë me dije për “Radion Evropa e Lirë” se ka shtuar masat e sigurisë në procedurat që bëhen gjatë transferimit të mjeteve financiare nga Thesari i Kosovës. Këto masa të shtuara të sigurisë vijnë pas një transferimi të paautorizuar në vlerë të mbi 2 milionë eurove, të bërë më 9 tetor nga një punonjës i Thesarit të Kosovës në një llogari bankare të një kompanie private.

Lulzim Krasniqi, këshilltar i ministres së Financave, Hykmete Bajrami, në një përgjigje me shkrim, i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se janë rishikuar qasjet dhe autorizimet e stafit, duke shtuar nivelet e kontrollit dhe ndarë deytrat, në pajtim me udhëzimet profesionale. Në bazë të këtyre udhëzimeve, ai thotë se aktualisht të gjitha proceset janë rikonfiguruar dhe e gjithë situata është nën kontroll të plotë dhe mjetet e buxhetit të Kosovës janë të sigurta.

Në pyetjen se a do të ndryshojë struktura e transferimit të mjeteve financiare të buxhetit të Kosovës pas këtij rasti, Krasniqi thotë se është hartuar një plan i veprimit dhe një strategji lidhur me këtë. “Disa veprime tashmë janë ndërmarrë. Do të ndërmerren edhe veprime të



tjera brenda vitit dhe në periudhën afatmesme, veprimet do t'i risin edhe me tej nivelet e kontrollit dhe sigurisë së qasjeve. Kësaj i paraprjnë auditimi dhe analiza e proceseve, në përpunëje me standarde më të larta të sigurisë”, thotë Krasniqi. Përgjegjësitet dhe menaxhimi i mjeteve financiare, në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, në kuadër të së cilës funksionon Thesari i Kosovës, janë të publikuara në procedurat për menaxhimin e qasjes së përdorueseve në Sistemin

Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës, i quajtur me shkurtesën SIMFK. Struktura e transferimit të mjeteve financiare të buxhetit të Kosovës, sipas rregullloreve, është e shpërndarë në disa zyrtarë, me hallka të shumta të kontrollit, kurse ka zyrtarë që kanë kompetenca më specifike. Në këtë sistem, përvëse punonjësve të Thesarit, të drejtë të qasjes kanë edhe punonjës të organizatave buxhetore që caktohen nga organizatat përkatëse, por vetëm pasi ta kenë

kaluar procesin e trajnimit dhe certifikimin për modulin përkatës. Për ekspertin e çështjeve ekonomike, Safet Gérxhaliu, ky rast po heshtet dhe nuk po hetohet krimi financiar që ka ndodhur. Kjo heshtje dhe tentativa për ta anashkaluar këtë problem, thotë Gérxhaliu, lë hapësirë që raste të tillë ka pasur edhe në të kaluarën dhe do të ketë edhe në të ardhmen. “Është koha që në këtë drejtim të punohet jo vetëm nga prokuroria vendore, por të angazhohet ndonjë mekanizëm ndërkombëtar për hulumtim të krimit financiar, që t'i luftojë dukuritë e tillë. Në Kosovë çdo ditë ndodhin gjëra të papritur dhe në këtë mënyrë lënë në harresë dukuritë negative që ndodhin, siç ishte edhe rasti i transferimit të paligjshëm të 2 milionë eurove nga Thesari i Kosovës”, thotë ai.

Pas transferim të paautorizuar të mbi 2 milionë eurove nga Thesari i Kosovës, komisioni disiplinor ka suspenduar dy zyrtarë të Thesarit në linjë vertikale të hierarkisë: zyrtarin/menaxherin e tavolinës ndihmëse dhe udhëheqësin e divizionit të menaxhimit të sistemit informativ të menaxhimit të financave.

Ministrja Bajrami gjatë raportimit para Komisionit për Buxhet dhe Transfere pati deklaruar se nga 2.1 milionë euro të transferuara nga Thesari i Kosovës, zyrtarët kanë arritur të bllokojnë mbi 5 590 mijë euro nëpër xhirologaritë ku janë transferuar paratë. Deri më tanë lidhur me këtë ngjarje, punëtori i Thesarit, Labinot Gruda dhe një nga pronarët e kompanisë “LDA Group”, në të cilën u transferuan paratë - me inicialet K. Sh., janë në paraburgim, ndërkëq një person tjetër vazhdon të jetë në arrati.

Bisedë me kryeshefin e ndërmarrjes "Trepça", Hysen Vrajolli

# 'Trepça' ka 8 milionë euro borxhe, kërkohet ndihma e qeverisë

Kryeshefi i ndërmarrjes "Trepça", Hysen Vrajolli, ka thënë se gjendja në këtë ndërmarrje nuk është e mirë dhe ka kerkuar ndihmë nga qeveria. Ai ka treguar se kjo ndërmarrje ka rrëth 8 milionë euro borxhe ndaj KEDS-it, ATK-së dhe furnitorëve. "Xhirollgaritë u bllokuan pasi kemi trashëguar një borxh prej 8 milionë eurosh dhe kjo çështje më pas shkoi te përmbaruesit. Këto borxhe janë ndaj KEDS-it 1.6 milion euro, kurse Administratës Tatimore të Kosovës i kemi borxh 4 milionë euro, pjesën tjetër ua kemi furnitorëve", ka thënë Vrajolli

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 8 NËNTOR** - Kryeshefi i ndërmarrjes "Trepçës", Hysen Vrajolli, ka thënë se në këtë ndërmarrje gjendja nuk është e mirë për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19 dhe rënies së çmimeve në bursat ndërkombëtare. "Gjendja nuk është e mirë pasi, për shkak të pandemisë, çmimet kanë rënë shumë në bursat

ndërkombëtare. Prandaj këtë vit do ta mbyllim jo mirë sa iu përket shitjeve të koncentrateve të 'Trepçës', ka thënë Vrajolli për gazeten "Epoka e re". Ai ka folur edhe për bllokimin e xhirollgarisë dhe për borxhet që ka ndërmarrja "Trepça" ndaj KEDS-it, ATK-së dhe furnitorëve.

Ai ka bërë me dije se ky borxh kap shifrën e rrëth 8 milionë euro. "Xhirollgaritë u bllokuan pasi kemi trashëguar një borxh




prej 8 milionë eurosh dhe kjo çështje më pas shkoi te përmbaruesit. Këto borxhe janë: ndaj KEDS-it 1.6 milion euro, Administratës Tatimore të Kosovës i kemi borxh 4 milionë euro, pjesën tjetër ua kemi furnitorëve", ka thënë Vrajolli. Sipas tij, alternativë për të dalë nga kjo gjendje është shitja e prodhimit të "Trepçës", subvencionimi ose kreditimi për këtë ndërmarrje.

Vrajolli ka thënë se janë kontraktuar dy kompani të huaja për shitjen e koncentratit të "Trepçës", megjithëkëtë, sipas tij, nuk është e mjaftueshme për t'i mbuluar pagat e punëtorëve dhe shpenzimet. "Ne kemi dy alternativa për zhbllokim të xhirollgarive. E para nga prodhimi ynë, mirëpo çështja është nëse do të mund t'i mbulojmë pagat dhe shpenzimet. Mënyra e dytë

është nëse marrim subvencionim nga qeveria ose ndonjë kreditim prej 5 milionë eurosh. Koncentratin e kemi shitur, tash mbetet vetëm liferimi dhe pritet të zhbllokohen xhirollgaritë. Pavarësisht kësaj, sërisht ne nuk mund t'i sigurojmë mjetet për pagë. Në pjesën jugore i kemi 1 370 punëtorë. Kemi gjetur kontraktim dhe i kemi shitur te një kompani angleze dhe një bullgare", u shpreh ai.

Vrajolli në këtë bisedë ka folur edhe për premtimet e qeverisë rrëth gjendjes për këtë ndërmarrje. "Ne kishim takim virtual me kryeministrin e Kosovë dhe ministrin Kuçi dhe na kanë premtuar se do të gjendet një zgjidhje për të dalë nga kjo bllokadë", u shpreh ai. Vrajolli ka theksuar se gjendja në pjesën veriore të ndërmarrjes "Trepça" është shumë e mirë për

shkak se ajo pjesë ka trashëguar një gjendje të mirë dhe nuk ka pasur ndërprerje të punës asnjë vit për dallim nga pjesa jugore që për shkaqe politike kishte pushuar rrëth dhjetë vjet. "Raportet me pjesën veriore janë në nivel profesional. Ata bashkëpunojnë me ne pasi asnjë subvencion nuk mund ta marrin pa kaluar përmes nesh, pra janë të obliguar që të raportojnë te ne. Gjendja në pjesën veriore është shumë më e mirë se te ne për shkak të gjendjes politike për dhjetë vjet. Minierat tonë janë shumë më të mëdha dhe kërkojnë më shumë investime. Po ashtu, kemi punëtorë më shumë. Kurse në pjesën veriore 'Trepça' ka pasur një gjendje të trashëguar shumë më të mirë dhe ka punuar edhe në kohën kur ne nuk kemi punuar", ka thënë kryeshefi i ndërmarrjes "Trepçës", Hysen Vrajolli.




# Oda Amerikane shpreh shqetësim për kufizim të veprimtarive afariste

**PRISHTINË, 8 NËNTOR (ER)** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me masat e ndërrmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin e ri për ndalimin e veprimtarive afariste pa konsultim paraprak me organizatat që përfaqësojnë interesat e sektorit privat. "Duke mirëkuptuar nevojën e mbrojtjes së shëndetit publik përmes ndërmarrjes së masave të duhura për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19, Oda Ekonomike Amerikane kërkon që në të njëjtën kohë të merren në konsideratë edhe

dëmet që kufizimi i veprimtarive afariste ka për ndërmarrjet e sektorit privat dhe mbijetesën e tyre. Për më tepër, vendimi i ri lë hapësirë për interpretim të dyanshëm për shkak të mospërcaktimit eksplicit të termave të përfshirë në vendim, i cili po rezulton në ndëshkimin e ndërmarrjeve private, siç është rasti me termin 'marketet e vogla' pa sqaruar se cilat elementet e përcaktojnë madhësinë e një ndërmarrjeje të shitjes me pakicë", është thënë në reagimin e Odës Ekonomike Amerikane.

Sipas OEAK-ut, formulimet e tillë çojnë në ndëshkim të



padrejtë të ndërmarrjeve private, të cilat, me gjithë vështirësitet e shkaktuara nga pandemia Covid-19, kanë bërë më të mirën që ta vazhdojnë aktivitetin e tyre dhe t'i ruajnë vendet e punës, por edhe në trajtim jo të barabartë të

ndërmarrjeve të ndryshme brenda sektorëve të njëjtë. "Duke ndarë shqetësimet edhe me përfaqësuesit e sektorëve të caktuar afaristë, Oda Ekonomike Amerikane i bënë thirrje qeverisë që të mundësojë komunikimin përmes mekanizmave ekzistuese të dialogimit ose formave të tjera, t'o marrë në konsideratë shqetësimet dhe rekomandimet e sektorit privat, si dhe t'i përcjellë me masa specifikë mbështetëse vendimet e saj për kufizimin e aktivitetit afarist", është theksuar në reagimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

# Ç'orkestër kundër çlirimtarëve!



**Shkruan: Agron HOTI**

Që prej se ekziston njerëzimi ekzistojnë dhe luftërat. Në luftë nuk shkojnë të gjithë, por vetëm ata që munden dhe kanë guximin ta shkrepin armën kundër armikut. Lufta nuk pyet në të jesh bujk, intelektual, i urtë apo agresiv. Ajo do njerëz që janë të gatshëm për të. Llojet e luftërave kanë qenë gjithmonë të ndryshme duke filluar nga ato çlirimtare e deri tek ato pushtuese. Luftërat pushtuese bëhen për të nënshtruar apo shfarosur popuj, siç ka ndodhur jo rrallëherë në histori, për dominim e primat si dhe për të pushtuar toka e resurse të huaja. Ndërkohë që luftërat çlirimtare, përpos që gjithnjë imponohen nga pushtuesit, bëjnë pikërisht të kundërtën e luftërave pushtuese.

Shqiptarët historikisht bënë vetëm luftëra çlirimtare. Nëse si popull shqiptar nxjerrim një bilanc mbi 2500-vjeçar, atëherë nuk është e vështirë të vërtetohet fakti se fatkeqësia apo madhështia më e madhe e shqiptarëve për dallim prej popujve evropianë është se gjithmonë bëmë luftëra

çlirimtare dhe vetëm çlirimtare, asnjëherë nuk patëm projekte pustuese apo zgjeruese në kuriz të popujve tjerë siç patën pothuaj të gjithë popujt evropianë. E pushtuesit, që prej se ekziston njerëzimi, problemin e kanë pikërisht me çlirimtarët, sepse janë çlirimtarët ata që i kthejnë armën pushtuesit. Kjo nuk do të ndryshojë as në të ardhmen. Perandoria Romake sulmonte pikërisht ata prijës të fiseve ilire që i kthenin shpatën, kujtoni luftërat iliro-romake.

Perandoria Osmane sulmonte Skënderbeun me patriotë tjerë shqiptarë, sepse ishte pikërisht ai që po i prishte planet pushtuese. Serbia, Greqia dhe sllavë tjerë të Jugut që 150 vite luftojnë ato forca të shumta shqiptare, që me armë në dorë, për aq sa mundnin, po prishnin planet pushtuese të tyre. Jugoslavia përndiqte, luftonte e vriste pikërisht ata shqiptarë që po bënë plane për kryengritje të armatosur kundër saj. Të njëtin avaz e vazhdoi Serbia deri në luftën e vitit 1998-1999.

NATO intervenoi ushtarakisht pikërisht për të ndëshkuar strukturën ushtarake, forcat policore dhe paramilitare serbe, të cilat po zbatonin projektin gjenocidal të politikës serbe kundër popullit shqiptar. Gjithsesi që Serbia dhe sllavë tjerë të jugut, sikur të gjithë pushtuesit në Evropë dhe botë,

përpos që ndiqnin dhe vrisnin pa asnjë mëshirë shqiptarët që kishin rrokur armët kundër tyre, nuk kursyen kurrë nga terrori as gra, as fëmijë e as pleq, kjo për të shfarosur shqiptarët kudo që ishin.

Derisa populli shqiptar edhe sot vazhdon të mbetet populli më i varfër, më i ndarë, më i nëpërkëmbur, më i përçarë dhe pse jo më i papërkrahuri në Evropë, siç deri dje ishte më i terrorizuar dhe gjenociduar në Evropë, asnjëherë brenda vetes - pavarësisht rrethanave të rënda historike si popull - nuk pranoi antivlera evropiane siç ishin luftërat pafund pushtuese (përfshirë luftërat e tmerrshme fetare) që popuj të ndryshëm të Evropës kishin bërë brenda dhe jashtë saj. Populli shqiptar edhe pse i pushtuar nga Perandoria Osmane - me aq sa pati, ditë dhe mundi i kryesuar nga Skënderbeu, po bënte luftë çlirimtare përvete dhe përtër Evropën. Të njëjtat përpjekje titanike po i bënte populli shqiptar dhe kundër Perandorisë Romake, e cila me pushtimin e saj zhduku gjurmë e gjurmë të ilirëve e pellazgëve, paraardhësve të drejtpërdrejtë të shqiptarëve. Njëjtë vazhdoi dhe Perandoria Romake e Lindjes, pra Bizanti.

Edhe në aspektin fetar, nëse populli shqiptar si pasardhës i drejtpërdrejtë i pellazgëve dhe ilirëve nuk ishte as katolik,

ortodoks e as mysliman, ishin pikërisht evropianët ata që na bënë katolikë e ortodoksë dhe osmanët ata që na bënë myslimanë. Pra, duke qenë populli më i vjetër në Evropë dhe duke bërë përpjekje titanike përvëruar origjinalitetin dhe autoktoninë, populli shqiptar nuk mori asnjë element nga lindja siç ishin krishterimi dhe myslimanizmi. Kurse Evropa sot është shumica e krishterë, një vlerë kjo që gjenezen e ka saktësisht në lindje. Ishte vetë Greqia ajo që vinte nga Egjipti i lashtë dhe që në Evropë po instalonte vlera lindore dhe përkëtë ka libra e libra. Duke mbetur historikisht origjinalë jo rastësisht mbeti Gjuha Shqipe si fosilja më e vjetër në Evropë, e një populli gjuha e të cilit është e veçantë nga të tjerat. Madje veçantia, pastërtia, pasuria dhe begatia e saj kishte arritur ta guduliste edhe mendimtarin dhe dijetarin e shquar gjerman të kohës Gottfried Leibniz, fakt ky që e përmend shkrimitari i ynë i madh Ismail Kadare në librin e tij eseistik "Mosmarrëveshja". Nuk do mend që shqiptarët ishin shembull i të qenit autokton, origjinalë, fisnikë, human dhe përmend shkrimitari i ynë i madhështi apo fatkeqësi po jua lë juve të vendosni lexues të nderuar. Gjithsesi, edhe pse të krishtëruar nga Evropa dhe të myslimanuar nga Perandoria

Osmane, shqiptarët tradicionalisht kanë arritur ta kapitalizojnë dhe transformojnë trekonfesionalizmin si vlerë, si tolerancë dhe si akceptancë, diçka që Evropa dhe pothuaj askush në botë asnjëherë nuk ka mundur dhe ende nuk po mund ta bëjë. Ndërsa, kjo vlerë shqiptare trekonfesionale tolerante dhe akceptante, sado e injektuar nga Evropa dhe Perandoria Osmani, asnjëherë nuk i ka pëlqyer Serbo-Rusisë, e cila, nga zilia, vazhdimisht është munduar dhe ende mundohet ta godasë pikërisht këtë harmoni t r e k o n f e s i o n a l e brendashqiptare si shembull dhe vlerë përmashash globale. Të kthehemti te luftërat pushtuese si anti-vlerë evropiane dhe jo vetëm. Mos të harrojmë se Evropa vetëm me ndihmën e ShBA-së, edhe atë vetëm një herë si duhet në histori arriti që globalisht ta dënonë luftën pushtuese të Gjermanisë si anti-vlerë evropiane, përndryshe luftërat, si anti-vlerë evropiane, asnjëherë para dhe pas luftës pushtuese të Gjermanisë nuk morën përgjigjen e duhur evropiane. E kjo i konfirmonte luftërat pushtuese si antivlerë evropiane nga vetë Evropa. Ndërkohë që shqiptarët që mbi 2500 vjet dëshmuani se janë kundër vlerave anti-evropiane të Evropës, pra luftërave pushtuese, e që ishin mijëra të tilla (përfshirë luftërat fetare)



nga Evropa brenda dhe jashtë saj, përfshirë kolonizimet e tmerrshme dhe terrorizuese nëpër botë. E absurdi është se shumë shtete evropiane këto kolonizime të tyre edhe sot i quajnë kulmi i qytetërimeve të tyre. Pra, lufta pushtuese si antivlerë tentohet të shitet si vlerë evropiane. Dhe kur në linjë me antivlerat evropiane po bashkojë dëshira e Rusia me disa aleatë evropianë që po mbështesin satelitët e tyre greko-sllavë për të marrë sa më shumë toka të shqiptarëve në kohën kur Perandoria Osmane po vdiste dëshira ku për shkak të kësaj padrejtësie historike pati filluar vetë Lufta e Parë Botërore, shqiptarët edhe pse u munduan të mbroheshin nga fqinjët gllabërues sllavo-grekë, u dëmtuan në njerëz, territore e resurse më shumë se çdo popull në Evropë e ku paqja e brishtë evropiane po mbahej hëpërheq vëtëm mbi kurzirin e shqiptarëve për të cilët Maurico Druon, sekretar i Akademisë Frëngje thoshte se "shqiptarët u përkasin popujve më të vjetër se vëtë historia, dhe gjyshërit e shqiptarëve merrnin pjesë në luftën e Trojës, të udhëhequr nga Akili (në njëren anë) dhe Hektori (në anën tjetër)". E kjo asnjëherë nuk i bëri përshtypje Evropës.

Ndërsa derisa Evropa dhe bota gjatë Luftës së Ftohtë po armatoseshin si asnjëherë më parë në histori të njerëzimit, shqiptarët edhe ashtu të gjendur nën dhunë e terror sllavo-grek, po arrinin t'i dhuronin Evropës dhe botës dy gjigantë humanistë që paqen, lirinë, të drejtat e njeriut dhe humanizmin e kishin synimin e tyre global: ishin këta pishtari i paqes, lirisë dhe të drejtave të njeriut Adem Demaci apo Ademi i Evropës dhe Gonxhe Bojaxhiu apo humanistë globale Nënë Tereza që po i jepnin leksion Evropës. Dhe derisa Millosheviqi po terrorizonte shqiptarët e Kosovës, drejtuesi politik, Ibrahim Rugova, në anën tjetër me aq sa mundej po e promovonte paqen, edhe pse të përkohshme, pikërisht në Evropën që kishte nisur Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore dhe që përmes Millosheviqit po pranonte në djepin e saj luftërat pushtuese si anti-vlerë të saj. Pra, nëse shtete të shumta në Evropë kishin shkaktuar luftërat pushtuese përmashash planetare me qindra miliona të vrasë, masakruar e zhdukur për të mos u gjetur kurrë, shqiptarët me Skënderbeun në krye, të koordinuar me Venedikun dhe me luftërat e tyre çlirimtare po mbronin pragun e shtëpisë dhe të Evropës. Ndërsa me Ademin e Evropës shqiptarët po i tregonin botës për sakrificën tërë-jetësore të një shqiptari të burgosur për bindje kombëtare nga regjimi kriminal jugosllav e që pavarësisht këtij terrori ky kolos shqiptar po bënte përpjekje



titanike për paqe, liri dhe të drejta të njeriut në zemër të një Evropë që po mundohej kinse të bashkohej.

Kurse me humanisten Nënë Tereza dhe pacifistin Ibrahim Rugova, shqiptarët po i jepnin leksionin e radhës Evropës dhe botës se c'përmashash mund të jetë humanizmi dhe pacifizmi i popullit shqiptar, popull ky i cili para syve të Evropës po terrorizohej dhe gjenocidohej nga Serbia historikisht fashiste. Ky humanizëm dhe pacifizëm i pasembullt evropian i popullit shqiptar dëshmon më së miri përrrenjët e vërteta fisnike të popullit shqiptar, padyshim më të vjetrit në Evropë, i cili logjikisht duke marrë parasysh terrorin e pushtimet konstante që kishte përfjetuar ndër shekuj nuk do të duhej fare të ishte pacifist, fisnik e humanist siç historikisht ka qenë. Duke qenë historikisht i terrorizuar dhe duke përfjetuar vazhdimisht sulme të pushtuesve për shfarosje, populli shqiptar me aq sa mundi, diti dhe e lejuan rrëthanat e mori në mbrojtje popullin hebre, e ky i fundit, gjatë tërë historisë së tij sikurse shqiptarët, e sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore po rezikonte shfarosjen përfundimtare.

Vetë karakteri i pastër i luftës çlirimtare të Kosovës tmerronte Serbinë me aleatë, të cilët vazhdimisht mundoheshin, por pa sukses, që luftën çlirimtare ta paraqisin si luftë fetare kundër vlerave evropiane, si luftë terroriste dhe si luftë kundër ekzistencës së popullit serb. Pra, shqiptarët i treguan Serbisë dhe botës që bëjnë vetëm luftë çlirimtare të imponuar nga vëtë Serbia me aleatë, e nuk bëjnë kurrfarë lufte fetare sepse fetë apo trekonfesionalizmi (katolik, ortodoks dhe mysliman) që gjenezën e kanë në lindje, shqiptarëve iu mveshën si vlera joshqiptare dhe joevropiane. E duke qenë se tri fetë erdhën nga lindja, shqiptarët mirëmbajtën vazhdimësinë pellazgo-ilire si bazamentin e identitetit shqiptar

të bazuar në gjuhë, traditë e kulturë e jo në fe siç ndodh me shumë popuj evropianë dhe jo vetëm. Në luftën e Kosovës po përballeshin drejtëpërdrejtë originaliteti dhe autohtonja paqësore shqiptare, përballë luftës pushtuese serbe si antivlerë evropiane. Duke qenë se pas disfatës nga NATO, Serbia nuk po mund t'i godiste më tutje çlirimtarët, atëherë kaloi në mjete tjera më të sofistikuara përmes shërbimeve inteligente duke u mbështetur fuqishëm nga Rusia. Ideja ishte dhe është edhe sot që Rusia ashtu sikurse Serbia e shihnin dhe ende e shohin Kosovën si projekt amerikan dhe kjo sipas Serbo-Rusisë duhej goditur në të gjitha format e mundshme në mënyrë që ky projekt amerikan të dështonte, e duke dështuar projektin amerikan, pra Kosova, atëherë NATO dhe Amerika do të akuzoheshin si mbështetëse të terroristëve shqiptarë siç Serbo-Rusia e quan vazhdimisht Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. E duke rrëzuar projektin amerikan, Rusia do të mund të arsyetonte veprimet e saj kriminale nëpër zona të ndryshme përreth saj, si në Ukrainë, Kaukaz, Krine, etj. Sigurisht që për planet e Serbisë edhe prezenca e një shqiptari të vëtëm në toka shqiptare është pengesë, prandaj rrokja e armëve nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me aq sa patën, ditën dhe mundën brenda atij terrori të paparë serb – e pengonte aq shumë Serbinë saqë solli mbi 100.000 forca policore, ushtarake dhe paraushtarake vëtëm e vëtëm për të gjunjëzuar shqiptarët. Sikur të mos i mjaftonin të gjitha këto forca, Serbia armatosi deri në dhëmbë pothuaj të gjithë qytetarët serbë që jetonin në Kosovë. Jo pak shqiptarë u vranë e u masakruan pikërisht nga fqinjët e tyre serbë. E për të njëjë buzë greminës projektin e Kosovës, pra projektin amerikan siç e sheh Serbo-Rusia Kosovën dhe popullin shqiptar në përgjithësi, Serbo-Rusia filloj i intensifikojë

përpjekjet për të mbjellë përqarje, kaos, dekurajim dhe demoralizim gjithëkombëtar brenda popullit shqiptar dhe përhir të së vërtetës nuk është që nuk ia kanë arritur. Shikoni përqarjet dhe thyerjet e thella mes shqiptarëve kudo që janë. Shihni Shqipërinë, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, shqiptarët e Malit të Zi, shqiptarët e diasporës, Kosovën dhe Kosovën lindore. Dhe këtë Serbo-Rusia po e bën pikërisht në kohën kur shqiptarët, edhe pse ende më të pazhvilluarit në Evropë, me ndihmën dhe mbështetjen konstante amerikane asnjëherë në historinë e tyre nuk kanë jetuar më mirë. Duke parë Serbo-Rusia që Kosova po shënonë mbi 100 vjet që nuk kanë jetuar më mirë. Duke parë që Kosova kishte filluar të ndërtonte infrastrukturë moderne dhe konkurruese, duke parë përafërimin institucional të Kosovës me Shqipërinë, duke e parë forcimin e ngadalshëm por të sigurt të elementit shqiptar në Ballkan, Serbo-Rusia u ngrit me tërë arsenalin e saj propagandistik për të paraqitur shqiptarët si agresorë të serbëve, si kriminelë, si fundamentalistë islamikë, si të paaftë për qeverisje dhe si mish i keq midis qytetërimit evropian. Ndërkohë që pasojat russo-serbe ndaj Evropës askush më mirë se vëtë Evropa nuk i njeh. Të gjitha këto etiketë të rëndë sigurisht që u mbështetën edhe nga shqiptarët të Kosovës nëpër kapacitete të ndryshme. Dhe nuk është fare rastësi që një pjesë e këtyre njerëzve në Kosovë, që janë thellësish kundër krerëve çlirimtarë të UÇK-së, i urrejnë këta çlirimtarë po aq sa Serbo-Rusia. Çfarë emëruesi fatal i përbashkët mes Serbo-Rusisë dhe disave në Kosovë kundër djemve dhe vajzave më të mira të kombit shqiptar, të cilët të mbështetur fuqishëm nga NATO ia dolën të shkatërronin Jugosllavinë pushtuese dhe të çlironin Kosovën që po e gjëzojmë të gjithë, por pavarësisht kësaj

çlirimtarët urrehe nga një pjesë e shqiptarëve të Kosovës po aq sa nga serbët. E Serbia, goditjen do ta bënte pikërisht ndaj çlirimtarëve, sepse ishin çlirimtarët që shkatërruan vëllazërim-bashkimin jugosllav dhe ata që në fakt shkatërruan Jugosllavinë dhe pothuaj tërë planet shfarosë serbe. Serbo-Rusia i godet çlirimtarët, sepse ashtu vepron çdo pushtues. Dhe tashmë, goditja ndaj shtetit vëtëm 12 vjeçar të Kosovës nga Serbo-Rusia është bërë fuqishëm dhe në shumë dimensione. Ku tjetër mund të bëhej goditja e projektit të Kosovës sesa në Këshill të Evropës, institucion ky ku ndikimi i Rusisë është i madh pikërisht për shkak të shantazhevë që u bën Rusia shteteve të ndryshme evropiane me gazin e saj dhe politikave tjera destruktive siç janë financimet e partive popullske anembanë BE-së. Duke qenë se Serbo-Rusia dështoi në: Rambuje, në parandalimin e Pavarësisë së Kosovës, në Gjykaten Ndërkombëtare të Drejtësisë, në parandalimin e njohjeve të Pavarësisë së Kosovës, në Këshill të Sigurimit, në NATO dhe në BE, atëherë e vëtmja alternativë që i mbeti Serbo-Rusisë për të prezantuar raportin e Dick Martyt të mbështetur dhe nga disa shqiptarë të Kosovës nëpër kapacitete të ndryshme. Antishqiptarizmin e Raportit të Dick Martyt e shohim më së miri në ballinat e gazetave serbo-ruse dhe në media të ndryshme globale që tashmë bëjnë me qisht kah lufta çlirimtare e UÇK-së duke u munduar ta kriminalizojnë atë, e duke u kriminalizuar UÇK-në sigurisht që kriminalizohet Kosova, e duke u kriminalizuar Kosova njëjtësitet lufta çlirimtare e Kosovës me atë pushtuese serbe. Prandaj, Gjykata Speciale është vëtëm njëra goditje e fortë e super-orkestruar kundër çlirimtarëve dhe vëtë shtetit të Kosovës, e cila, edhe pse do të lë pasoja pas, do të dështojë siç kanë dështuar shumë orkestrime të tjera.

# Manaj me këmbë në tokë: Ende nuk jam ambientuar në Turqi

Arb Manaj ka shënuar brenda javës tri gola për skuadrën e Keciorengucut, por për "Epokën e re" ka thënë se ende nuk është ambientuar në futbollin e Turqisë. "Jam shumë i lumtur se po kaloj nëpër një formë mjaft të mirë, por gjithmonë ka vend për përmirësim. Ende nuk jam ambientuar në futbollin e Turqisë, por do të vazhdoj të punoj shumë siç kam bërë gjithmonë dhe me kohë do të ambientohem", ka thënë Manaj

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 8 NËNTOR** - Sulmuesi nga Kosova, Arb Manaj, është duke shkëlqyer në Ligën e Pare të Turqisë, pasi brenda javës ka shënuar tri gola për skuadrën e Ankara Keciorengucu. Sulmuesi nga Klina të dielën për "Epokën e re" ka thënë se ende nuk është ambientuar sa duhet në futbollin turk, por beson se me punën që është duke bërë një gjë e tillë do të arrihet shumë shpejt. "Jam shumë i lumtur që po kaloj nëpër një formë mjaft të mirë, por gjithmonë ka vend për përmirësim. Ende nuk jam ambientuar në futbollin e Turqisë, por do të vazhdoj të punoj shumë siç kam bërë gjithmonë dhe me kohë do të ambientohem", ka thënë Manaj.

Sulmuesi, pas dy golave në mesjavë që shënoi në kuadër të Kupës, të dielën ka shënuar edhe një gol vendimtar në minutat e fundit për t'i siguruar një pikë Keciorengucut në përbalje me Eskisehirsporin (2-2). Futbollisti shqiptar shënoi gol njëmbëdhjetë minuta pas inkuadrimit në lojë. "Pas golave të shënuara normalisht se jam shumë i lumtur, sepse detyrë e sulmuesve është të shënojnë. Golat janë një motiv i madh që të vazhdoj të stërvitem fort dhe të shënoj në vazhdimësi. Nga stafi dhe trajneri kam marrë lëvdata për paraqitjet e bëra dhe golat e shënuara", ka shtuar ai.

I pyetur për dallimin në mes të Superligës së Kosovës dhe Ligës së Parë të Turqisë, Manaj është përgjigjur: "Dallimi ekziston sepse futbolli këtu është më fizik dhe ritmi është më i shpejtë". Arb Manaj është zhvilluar shumë si futbollist dhe arritet e gjertanishme janë për çdo lëvdatë, pasi ai gjatë karrierës është përballur me shumë vështirësi. Në moshën 17 vjeçë, Manaj kishte pësuar dy lëndime të rënda dhe i ishte dashur të pushonte për dy



vjet, por ai gjeti forcën dhe arriti që të rikthehet edhe më i fuqishëm. Manaj ka luajtur për City Sport dhe KF Dukagjini 2000, pastaj për KF Dukagjini dhe Trepçen '89. Në

edicionin e kaluar, Manaj me fanellën e Trepçës '89 ishte lojtar më i mirë, por edhe në Superligë ishte më mesin e golashënuarëve dhe lojtarëve më të mirë.

## SHKURT

### Ndërroi jetë Skënder Ramadani

Ka ndërruar jetë Skënder Ramadani, ish-futbollist i Ferizajt në vitet '70, ndërsa kontribuoi edhe si anëtar i Komitetit Ekzekutiv i FFK-së nga regjioni i Ferizajt, në kohën kur ky institucion drejtohej nga Sabri Hashani. "Në emrin tim, Komitetit Ekzekutiv, klubeve, futbollistëve dhe tërë komunitetit të futbollit u shpreh ngushëllimet më të sinqerta. Skënder Ramadani dha kontribut të çmuar për futbollin e Kosovës. Ai në rininë e hershme ishte pjesë e KF Ferizajt dhe në vitet '70 ishte ndër futbollistët më të mirë ferizajas, duke qenë edhe kapiten i skuadrës. Ndërsa, me përvojën dhe kapacitetet e tij intelektuale kontribuoi edhe si anëtar i Komitetit Ekzekutiv i FFK-së nga regjioni i Ferizajt në kohën kur ky institucion drejtohej nga Sabri Hashani", thuhet në telegram ngushëllimin e kryetarit të FFK-së, Agim Ademi.

### Kosovare Asllani realizon dy gola për Realin

Kosovare Asllani i ka realizuar dy gola për Real Madridin në fitoren 3:1 të shënuar në udhëtim ndaj Eibarit, në xhiron e gjashtë të elitës së futbollit të femrave në Spanjë. Të dyja golat Asllani i realizoi nga penaltia në minutën 47 dhe 55. Ajo luajti tërë ndeshjen.

### Lëndohet Ronaldo

Cristiano Ronaldo e ka lënduar nyjën e këmbës në barazimin e Juventusit ndaj Lazios (1-1). Sulmuesi portugez u nxor nga loja në minutën e 73-të dhe u zëvendësua nga Paulo Dybala. Ronaldo u largua nga fusha me dhimbje dhe duke çaluar. 35-vjeçari që shënoi golin e vetëm të Juves në këtë ndeshje, është ftuar nga Portugalia për ndeshjet e nëntorit.

### Brahimaj, pas humbjes: Jam mirë, rikthehem më i fortë

Luftëtar shqiptar Ramiz Brahimaj ka pësuar humbje në debutimin e tij në UFC në Las Vegas. Brahimaj u ndal në raundin e tretë nga Max Griffin. Referi kishte ndërprerë meçin, pasi pa lëndimin e rendë që kishte marrë në vesh Brahimaj. Luftëtar shqiptar në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se është mirë dhe se do të kthehet më i fortë. "Përsëndetje të gjithëve! Jam mirë. Thjesht, është një plagë sipërfaqësore. Uroj kundërshtarin tim që bëri luftë të madhe dhe jam vërtet i lumtur që ndava kafazin me të dhe i uroj gjitha të mirat. Unë do të shërohem e do të kthehem sérish. E vlerësoj nga shpirti gjithë përkrahjen që kam marrë. Goditjet nuk janë asgjë e re për mua. Thjesht, do të më bëjnë më të fortë. Shumë dashuri dhe do të kthehem së shpejti", ka shkruar Brahimaj. Brahimaj është bërë luftëtar i dytë shqiptar që ka luftuar në serinë më të madhe të Arteve Marciale të Përziera (MMA), në UFC. Në këtë seri lufton edhe Ilir Latifi.

## Morina: Kryeziu e meritoi ftesën nga Kosova U21

**PRISHTINË, 8 NËNTOR** - Vetëm tre muaj me skuadrën i mjaftuan Arbnor Morinës që të nxjerrë lojtarë të gatshëm për Përfaqësuesen U21 të Kosovës. Sulmuesi i rrezikshëm, Almir Kryeziu, ka pranuar ftesën e Kosovës U21. Trajneri i skuadrës,

Arbnor Morina, në një bisedë me "Olle" ka treguar që është shumë i kënaqur me këtë ftesë, teksha beson që shumë shpejt edhe futbollistë të tjerë të kësaj skuadre do të bëhen "legjonarë". "Natyrish se ndihem shumë i kënaqur me

këtë lajm. Puna, serioziteti, përkushtimi dhe sakrifica si dhe disiplina gjatë stërvitjeve kanë bërë që Almir Kryeziu ta meritojë plotësisht këtë ftesë", ka thënë Morina. "Unë besoj se shumë shpejt edhe futbollistë të tjerë nga KF Arbëria do ta veshin

fanellën e Kombëtares së Kosovës U21, sepse e meritojnë plotësisht. Kështu është kur talentit që ke, ia shoqëron edhe gjithë përkushtimin dhe angazhimin dhe, natyrisht, kjo shpërblehet në fund", ka deklaruar Morina.



## Më 21-22 nëntor mbahet turneu i boksit 'Adem Jashari'

**PRISHTINË, 8 NËNTOR** - Më 21-22 nëntor do të mbahet turneu ndërkontrollor i boksit "Adem Jashari", ka njoftuar Federata e Boksit e Kosovës. Deri më tash pjesëmarrjen e kanë konfirmuar boksierë nga gjashtë shtete: Bullgaria, Zvicra, Sllovenia, Maqedonia, Mali i Zi e Shqipëria, ndërsa po pritet konfirmimi edhe nga Suedia e Kroacia.

Federata e Boksit e Kosovës ka njoftuar se pasi palestra e sporteve në Prishtinë është e rezervuar në atë datë, turneu "Adem Jashari" do të mbahet në palestrën "Dilloni Benz" në Fushë-Kosovë. "FboxK do t'i respektojë këshillat e dala nga IKShPK-ja, MKRS, MSh-ja që në palestra të myllura mos të ketë më shumë se 50 persona (garues, trajnerë, delegatë, mjekë sportivë etj.) turneu do të zhvillohet pa publik", thuhet në njoftimin e Federatës së Boksit.

Gjysmëfinalet do të organizohen më 21 nëntor nga ora 17:00, ndërsa finalet më 22 nëntor nga ora 12:00.



## Tirana pësoi humbjen e parë, Kukësi të dytën

**TIRANË, 8 NËNTOR** - Tirana ka pësuar humbjen e parë në javën e dytë të Kategorisë Superiore. "Bardheblutë" u mundën 1-0 nga Teuta në sfidën e luajtur në Pogradec. "Bregdetarët" shënuan me anë të Lorenci Vilës që dërgoi topin në rrjetë në minutën e 32-të. Futbollisti i tregua i saktë me kokë pas një krosimi fantastik të Dejvi Bregut, duke e dërguar topin në cepin e portës. "Bardheblutë" kërkuan me ngulm golin e barazimit në fraksionin e dytë, por Cobbinah dhe sulmuesit e tjerë nuk u treguan të saktë, raporton "KJ". Partizani shijoi tri pikët e para në kampionat, pasi fitoi kundër Kukësit. "Të Kuqtë" do të fitonin pastër 2-0 në duelin e luajtur në Shkodër. Në minutën e 60 Solomon del mjaft mirë në krahun e djathët dhe më e shërbën në zonë për Lucas Cardozon, i cili nuk do të gabonte. Kukësi kërkoi golin e barazimit, por në fundin e ndeshjes do të pësonin edhe të dytin



një minutë nga fundi i kohës së rregullt nga Solomon. Skënder Gega e ka nisur me dy humbje në dy sfidat e para aventurën te "Të Kuqtë". Laçi nuk shkoi më shumë se një barazim 1-1 kundër Kastriotit. Musta zhbllokoi ndeshjen në minutën e 48-të, teksha miqtë mbetën edhe me një lojtar më pak në fushë në pjesën e dytë. Gjithsesi krutanët nuk u dorëzuan duke shënuar në shtesë me Sebino Plakun.

## Reali bën gati 100 milionë euro për Haalandin

Real i Madridit është i bindur se Eling Haaland do të jetë sulmuesi i tyre në të ardhmen. Autori i 10 golave mes Bundesligas dhe Ligës së

Kampionëve në vetëm pak javë, pëlqehet shumë nga presidenti i "Los Blancos", Florentino Perez. Sipas mediave spanjolle, pritet të

ofrojë 100 milionë euro për shtatlartin nordik, me 80 milionë euro që do të shkojnë në arkat e Dortmundit dhe 20 milionë euro të tjera si

komision për futbollistin, mbetet për t'u parë se cila do të jetë përgjigjja e Dortmundit që pretendon shumë më tepër para për Haaland. Në garë për

norvegjezin janë edhe disa skuadra të tjera të mëdha si Liverpool, United dhe Juventus, ndaj dhe nuk do të jetë e thjeshtë.

## SHKURT

### Di Maria: Dua ta përfundoj karrierën në PSG

Sulmuesi i PSG-së, Angel Di Maria, kundër Rennes shënoi dy gola dhe dha një asistim për Moise Kean në triumfin 3-0. Pas ndeshjes ai është shprehur shumë i lumtur për fitoren si dhe ka deklaruar se dëshiron ta përfundoj në Francë karrierën evropiane. "Unë dua ta përfundoj karrierën time këtu, por jo gjithçka varet nga unë. Ndihem mirë këtu dhe jam i lumtur. Jam në një klub që më fal dashuri dhe unë jam duke bërë më të mirën time", ishin fjalët e 32-vjeçarit për "Canal +".

### Fati pëson lëndim të rëndë


Një nga talentet më të mëdhenj të futbollit, Ansu Fati u lëndua në ndeshjen ndaj Betisit (5-2). Ai ka dëmtuar meniskun e, përrnjedhjën, ka humbur grumbullimin me Spanjën për ndeshjet e nëntorit. Sulmuesi anësor "blaugrana" u zëvendësua nga Messi sapo nisi pjesa e dytë për shkak të problemeve me gjurin por, fatkeqësisht, sipas njoftimit të Barcelonës: "Testet e kryera kanë përcaktuar që Ansu Fati ka këputje të meniskut të brendshëm të gjurit të majtë. Në ditët e ardhshme do të përcaktohet dhe rruga që duhet ndjekur përi raftësimin e sulmuesit".

### Vidal: Ronaldo nuk mund të krahasohet me Messin

Mesfushori i Interit, Arturo Vidal, ka pranuar se ishte i detyruar të largohet nga "Camp Nou" gjatë verës. Vidal në verë u largua nga gjiganti spanjoll duke i bashkuar Interit, tek i cili është duke luajtur titullar. "Ishte rehatshëm te Barcelona, ishte një grup, bashkëlojtarë që ishin më shumë se miq. Kur je i lumtur, qëndron aty ku je. Pastaj gjërat ndryshuan dhe vendosa të vij tek Interi", ka thënë Vidal. I pyetur për debatin mes Lionel Messit dhe Cristiano Ronaldos, Vidal i quajti argjentinasin 'jashtëtokësor'. "Nuk ka krahasime në mes të CR7 dhe Messit, Leo është jashtëtokësor", ka shtuar Vidal.

### Flick: Bayerni fitoi me meritë ndaj Dortmundit

Bayern München e mposhti në derbi Borussia Dortmundin (2-3). Trajneri i Bayernit, Hansi Flick, ka folur për fitoren e arritur, duke thënë se ishte një ndeshje pozitive nga ana e skuadrës së tij. "Ndeshja ishte shumë pozitive, kishte shumë cilësi nga të dyja ekipe. Ne ishim më të vendosur sesa ata në disa situata. Dortmundi ishte i rrezikshëm falë gabimeve tona. Duhet të jemi më të duruar në disa raste, por kjo fitore ishte më se e merituar", ka deklaruar Flick. Pas shtatë javëve të para në Bundesliga, Bayerni tanimë është lider i vetëm në tabelë me 18 pikë, ku ka shënuar gjashtë fitore dhe ka një disfatë.



Izet Sarajliqi (1930-2002) është një ndër poetët boshnjak më të njobur. Sarajliqi është konsideruar një prej autorëve kryesorë të Evropës Lindore dhe është kandiduar për çmimin Nobel për letërsi. Sarajliqi ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnjë dhe Hercegovinës. Është vlerësuar me shumë çmime, edhe me çmimin prestigjioz "Alberto Moravia" (2001). Gjatë luftës (1992-1995) refuzoi të largohej nga Bosnja. Në këtë luftë, në të cilën u plagos, humbi dy motrat, Ninën dhe Razën, të cilat përmendën në këtë libër. Poezitë e Sarajliqit janë përkthyer dhe botuar në: italisht, frëngjisht, holandisht, gjermanisht, slovenisht, rusisht, lituanisht, anglisht, turqisht, maqedonisht, spanjisht, në gjuhën polake e në disa gjuhë të tjera të botës, edhe në shqip.




Në parathënien e këtij libri është ky paragraf. Në Sarajevë, të cilën e deshi shumë dbe me poezi shkruar përsë te bëri të njohur në mbarë botën, pothuaje askush nuk e kujton më. Madje asnjë rruga të këtij qyteti nuk ia dhanë emrin e tij. Kështu shkruan dhe shpreh shqetësim e bija e poetit, Tamara Sarajliq Slavniq, e cila, në korrespondecat me postë elektronike, na njofton se babai i saj, Izeti, sa ishte gjallë kishte qenë disa herë në Prishtinë, se i donte shumë shqiptarët, se u fliste fëmijëve të vet shumë për qytetet e Kosovës, për takimet që kishte pasur disa herë me poetë shqiptarë në mbërmjet poetike që atëkohë organizoheshin në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, shpreh kënaqësi që, pas librit të pare, Kërkoj rrugë përmirësim, përkthyer në gjuhën shqipe, në fund të viteve '70, nga Azem Shkreli, Enver Gjergjeku, Qerim Ujkani, Ali Podrimja dhe botuar nga Rilindja më 1978, po në shqipë po i përkthehet dhe botohet libri i dytë, Përbledhja sarajevase e luftës. Falënderimet e saj, për shtëpinë tonë botuese dhe për ata shqiptarë që kujdesen përvlera letarë dhe njerezore, për ata shkrimitarë që i do dhe i kérkon bota, që janë institucionë të kujtesës kombëtare, që ua kujtojnë gabimet shteteve dhe udhëheqësve të tyre, janë shumë të njerëzishme dhe janë shumë miqësore. Pas shumë fjalëve të saj përpunën tonë, i kemi dërguar në fund këtë fjali: Boshnjakët edhe mund ta barrojnë luftën, edhe ta barrojnë Sarajliqin, por ne s'do ta barrojmë kurrrë luftën e Bosnjës në varet e Izetit; s'do ta barrojmë kurrrë masakrën që i është bërrë popullit të tij; s'do ta barrojmë kurrrë fatin e përbashkët që kishim ju vetime atje, ne shqiptarët kudo.

N. Sh. Armagedoni

4.99 €



## PËRMBLEDHJA SARAJEVASE E LUFTËS



IZET SARAJLIQ

Përktheu: Salajdin Salihu

Shkroi parathënien: Tamara Sarajliq Slavniq



**Lume's Details**  
*Estetik & Depilim*

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[www.facebook.com/gjejpuneshepejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshepejte)

## RESTAURANT SWISS TAVERNA PRISHTINË

Tel: +377 45 400 156 | +386 49 848 553

- >> SHPALLJE TË VOGLA <<**
- Gjon Pjetraj shpalld të pavlefshme dëftesën e plotë të Sh.F.M.U. "Fan Noli" ne Dujakë KK Gjakovë.
- Shefki Shala shpalld të pavlefshme dëftesat e kl. I.I.II.IV dhe diplomën e Sh.M.T. "Nexhmedin Nixha" – Elektroinstalues, Gjakovë.
- Jap banesë me qira afër 60 m<sup>2</sup>, katë III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepsë shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërrloq, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, katë dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, katë dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian katë i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katë i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", katë tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershorë deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër të Prishtinës afër Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m<sup>2</sup>. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m<sup>2</sup>, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrore dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplekt. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, katë i l-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

An advertisement for RC Cola. At the top, the RC logo is displayed with the text 'ROYAL CROWN' above it. Below the logo, a yellow box contains the text 'ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS'. To the right, there are images of a blue RC Cola can and a dark plastic bottle. On the left, a dark blue sidebar lists 'Quality & Sales Award Recipients' in yellow text, with a note '(Listed in alphabetical order)' in smaller text below. The recipients listed include ARC Refreshments Corporation (Philippines), Embotelladora Central S.A. (Paraguay), Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. (Guatemala), Fluidi Sh.p.k. (Kosovo), Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda (Brazil), Interbrand S.A.L. (Lebanon), Kofola ČeskoSlovensko a.s. (Czech Republic), Obi Zulol CJSC (Tajikistan), Partex Sales Beverages Ltd. (Bangladesh), and Soft Drinks Georgia (Georgia).

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



An advertisement for RC Cola. At the top, the RC logo is displayed with the text 'ROYAL CROWN' above it. Below the logo, a yellow box contains the text 'ANNOUNCING THE 2017 QUALITY &amp; SALES AWARDS'. To the right of the text, there are images of a blue RC Cola can and a dark plastic bottle of RC Cola. In the bottom left corner, a dark blue box lists 'Quality &amp; Sales Award Recipients' with the note '[Listed in alphabetical order]'. The list includes: ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality; Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality; Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality; Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality; Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality; Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales; Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality; Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality; Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality; Soft Drinks Georgia Georgia, Sales.